



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi*, dëshmitari i 53-të i thirrur nga Prokuroria filloi dhënien e dëshmisë të hënën. Dëshmitari është Shon Bërns (Shaun Byrnes), i cili ishte shef i Misionit Amerikan të Vëzhguesve Diplomatikë në Kosovë nga gushti 1998 deri në korrik 1999. Z. Bërns vazhdoi dëshminë e tij të martën, mërkurën dhe të enjten e kësaj jave, gjatë së cilës atij i bënë pyetje Prokuroria dhe ekipet e Mbrojtjes.

Seanca e ardhshme në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët* është caktuar për të martën, 2 prill, duke filluar në orën 9:00 paradite. Javën e kaluar, Trupi Gjykses njoftoi se deri në pushimin veror të gjykatës, seancat do të mbahen prej orës 9:00 paradite deri në orën 16:30, gjysmë ore më shumë se sa ishin caktuar më parë.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 22 mars, Trupi Gjykses mori vendim në lidhje me një kërkesë të Rexhep Selimit për rishikim gjyqësor të tri kushteve të caktuara nga Administratorja lidhur me vizitat dhe komunikimet e z. Selimi në kuadër të zbatimit të vendimit të Trupit Gjykses të datës 1 dhjetor 2023.

Në vendimin e dhjetorit 2023, Trupi Gjykses konstatoi se z. Selimi, z. Thaçi dhe z. Veseli duket se u kanë dhënë vizitorëve informacion konfidencial të marrë në kontekst të procesit gjyqësor, ose që ishte dhënë gjatë dëshmisë së dëshmitarëve të mbrojtur. Si rrjedhojë, gjykatësit theksuan rrezikun e konsiderueshëm që këta tre të akuzuar do t'u nxjerrin informacion të privilegjuar palëve të treta të paautorizuara, dhe Trupi Gjykses urdhëroi që Zyra Administrative të vendoste një sistem përmes të cilit ulet ky rrezik.

Në kërkesën e tij për rishikim gjyqësor, z. Selimi kundërshtoi kufizimet lidhur me numrin e thirrjeve telefonike ditore, kohëzgjatjen e vizitave jo të privileguara, dhe intervalet midis vizitave dhe planifikimin e datave të tyre. Trupi Gjykses konstatoi se ishte i arsyeshëm përfundimi i Administratores se është e pamundur të bëhen ndryshimet që kërkon z. Selimi dhe që njëkohësisht të zbatohet plotësisht urdhrat e Trupit Gjykses dhe të përmbushë detyrimet e saj sipas Ligjit dhe Rregullores. Gjykatësit nxorën përfundimin se masat janë të domosdoshme dhe proporcionale në rrethanat, se ato mbështesin qëllime legjitime, dhe se Administratorja veprroi në një mënyrë që përputhet me mbrojtjen efektive të të drejtave të z. Selimi.

Trupi Gjykses përsëriti gjithashtu se kufizimet për të cilat u ankua z. Selimi u miratuan si reagim ndaj sjelljes së palejueshme që i atribuohet atij dhe kanë për qëllim garantimin e mospërsëritjes së kësaj sjelljeje dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të atyre që u vunë në rrezik.

Në të njëjtën kohë, Trupi Gjykses urdhëroi Administratoren të hulumtojë mundësi shtesë dhe të bëjë përpjekje të arsyeshme në lidhje me aspekte të caktuara të vizitave personale jo të privileguara dhe thirrjeve





telefonike. Për shembull, Administratorja duhet të hulumtojë mundësinë e lejimit të vizitave të njëpasnjëshme 40-minutëshe në të njëjtën ditë nga i njëjti vizitor.

Në çështjen gjyqësore *Januzi dhe të tjerët*, më 27 mars, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim ku përcaktoi hapat proceduralë të mbetur në fazën e procedurës paraprake. Vendimi theksoi se aspekti i financimit të Mbrojtjes duhet zgjidhur për të garantuar të drejtat e të akuzuarve dhe për të përgatitur lëndën sa më shpejtë për gjykim. Në veçanti, në vendim thuhet se, nëse ekipet e Mbrojtjes synojnë të kërkojnë ndihmë juridike nga DHSK-ja, ata duhet të dorëzojnë formularët përkatës dhe çdo dokumentacion mbështetës të nevojshëm deri më 12 prill 2024. Nga Zyra Administrative u kërkua që të trajtojë si urgjente çdo kërkesë të marrë prej saj.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake caktoi edhe disa afate të tjera në lidhje me detyrimet paraprake të palëve, përfshirë nxjerrjen e provave dhe dorëzimin e dosjeve paraprake. Gjykatësi i Procedurës Paraprake caktoi të premtën, 21 qershor, si datë për kalimin e dosjes gjyqësore Trupit Gjykues.

Në të njëjtën çështje, më 26 mars, Administratorja njoftoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake për caktimin e znj. Almudena Bernabeu Garcia si bashkëmbrojtëse të Haxhi Shalës.

Në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, tani është i disponueshëm versioni i redaktuar publik i parashtrimit të Administratores dorëzuar Gjykatësit të Vetëm, i datës 24 janar, ku ajo paraqet informacion për aspekte të zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim. Parashtrimin mund ta gjeni në faqen e internetit të DHSK-së.

Në lajme të tjera, ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim i Dhomave të Specializuara të Kosovës vizitoi Kosovën javën e kaluar, ku u takua me studentë të drejtësisë dhe shoqërinë civile në Prizren dhe Prishtinë. Që nga viti 2018, ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim është takuar me mbi 3,600 njerëz anembanë Kosovës, duke ofruar informacion gjykatën, duke dëgjuar mendimet dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

